

## Ndjekja e objektivave të përbashkëta

Këshilli për Qeverisje Përfshirëse (CIG) organizoi më 2 korrik 2022, në Shkup, Maqedoni e Veriut, tryezën e rumbullakët të radhës për deputetë aktualë dhe ish-deputetë nga Serbia dhe Kosova. Ata diskutuan se si të shtyhet përpara normalizimi në rrethanat e reja të krijuara nga lufta në Ukrainë si dhe analizuan situatën e marrëdhënieve ekonomike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në mesin e të ftuarve ishin politikanë kryesorë nga Maqedonia e Veriut dhe përfaqësues të Odës Ekonomike të Kosovës dhe Serbisë. Mbajtur sipas rregullës Chatham House, tryeza është pjesë e një projekti mbi normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, e mbështetur nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës (FDFA). Raporti nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e pjesëmarrësve individualë, CIG, ose FDFA, por më tepër bazohet në diskutimin në tërësi.

Pjesëmarrësit mësuuan nga përvoja e Maqedonisë së Veriut pas Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (OFA) të vitit 2001 dhe nga mësimet e nxjerra nga “Procesi i brendshëm i Mavrovës,” i lehtësuar nga Projekti për Marrëdhëniet Etnike (PER), organizatë pasardhëse e të cilës është CIG, dhe mbështetur nga FDFA. Ata gjithashtu mësuuan t’i vënë këto përvoja në perspektivë të dialogut ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. Deputetët e shohin dialogun si të domosdoshëm dhe theksuan se Kosova dhe Serbia duhet të jenë të vetëdijshme për koston e mosarritjes së marrëveshjes. Sa i përket bashkëpunimit ekonomik, pjesëmarrësit morën informacione të dorës së parë nga odat ekonomike të të dyja vendeve. Deputetët që janë anëtarë të komisioneve parlamentare përkatëse për ekonomi dhe tregti u zotuan që brenda komisioneve të trajtojnë pengesat e bashkëpunimit ekonomik dhe të raportojnë për vazhdimin në takimet e ardhshme të deputetëve të organizuar nga CIG.

### Ecja përpara në rrethana të reja

Takimi fillimisht u përqendrua në përvojat e krahasueshme nga rajoni - dialogu dhe kompromisi ndërmjet maqedonasve dhe shqiptarëve etnikë pas OFA, e cila ofroi një platformë për funksionimin e ri të shtetit. Në vitin 2001 kishte paqartësi lidhur me zbatimin e OFA-së dhe nëse ajo do të sillte paqe dhe kohezion. Për të mundur zbatimin, përfaqësuesit e partive maqedonase dhe shqiptare janë angazhuar në procesin vendor “Procesi i Mavrovës,” në të cilin palët diskutuan për zbatimin e OFA-së dhe çështje të tjera të rëndësishme që nuk ishin përfshirë në OFA. Pavarësisht mosmarrëveshjeve të mëdha për çështje specifike (si përdorimi i flamujve etnikë dhe statusi i Universitetit të Tetovës), palët mbetën të përkushtuara ndaj procesit. Ata mësuuan se si të dëgjonin njëri-tjetrin, me ç’rast arritën të kuptojnë më mirë pozicionet e njëri-tjetrit. Përfaqësuesit politikë të maqedonasve etnikë ndërmorën hapa të guximshëm dhe miratuan kompromise në parlament, edhe pse shumica e votuesve të tyre i panë ato lëshime si të panevojshme ndaj shqiptarëve etnikë. Pas zbatimit të pikave të dakorduara, problemet janë zhdukur në masë të madhe. Për shembull, Universiteti i Tetovës tani financohet nga shteti dhe askush në Maqedoninë e Veriut nuk e vë në dyshim ekzistencën e tij.

Mësimet e nxjerra nga ky proces që janë të rëndësishme për dialogun Serbi-Kosovë:

- **Diskutimet joformale “në pronësi lokale” kanë përgatitur një proces zyrtar më të mirë.** Ndonjëherë përparimet e rëndësishme kërkojnë kohë, por është thelbësore që të kemi një proces të brendshëm informal, një vend që u mundëson palëve të kuptojnë më mirë njëra-tjetrën, vullnet për të gjetur zgjidhje dhe kohë për biseda të brendshme që do të kontribuonin në një mirëkuptim më të madh.
- **Fokusi duhet të jetë në të ardhmen, jo në të kaluarën.** Është thelbësore të fokusohemi në të ardhmen për të qenë të vetëdijshëm për pasojat serioze të mosarritjes së marrëveshjes dhe për të zgjidhur problemet ashtu si lindin.
- **Çështje “të lehta” dhe “të ndërlikuara.”** Gjatë gjithë procesit informal, palët kuptuan se disa gjëra që janë konsideruar “të lehta” nuk janë aq të lehta dhe disa çështje të konsideruara “të ndërlikuara” rezultuan të lehta për t’u zgjidhur.
- **Mjedisi ndërkombëtar është thelbësor.** Në rastin e Maqedonisë së Veriut, nuk kishte pengesa të mëdha ndërkombëtare. Sot, me luftën në Ukrainë, situata është shumë më e paparashikueshme dhe palët duhet “të mësojnë të lexojnë saktë shenjat gjeopolitike për të bërë zgjedhjet e duhura.” Përndryshe, fuqitë e tjera do ta keqpërdorin procesin për qëllimet e tyre dhe “do të bëjnë zgjedhjet për ju.”
- **Të mos humben mundësitë për të mos u lënë pas.** Frika për të mbetur prapa në proceset integruese euroatlantike i detyroi politikanët në Maqedoninë e Veriut të bëjnë zgjedhjet e duhura. Mundësi të tilla nuk duhen humbur.

Një pjesëmarrës nga Kosova tha se lufta në Ukrainë me gjasë do të shërbejë si katalizator për një ndryshim në rajon dhe se proceset do të përshpejtohen. Palët në dialog janë të informuara për qëndrimet e njëra-tjetrës. Ato e dinë se çfarë është në rrezik, por kanë vështirësi të navigojnë rrugën drejt një zgjidhjeje. Prandaj, “ndoshta zgjidhja duhet të imponohet.” Një pjesëmarrës nga Serbia ra dakord me pohimin, duke argumentuar se situata në Ukrainë mund të inkurajojë BE-në dhe SHBA-në të ndërtojnë një marrëveshje.

“Serbia dhe Kosova janë në një moment ku duhet të bëjnë zgjedhje të cilat janë të vështira, por të cilat nuk do të bëhen më të lehta më vonë. Duhet të flasim edhe për koston e mosarritjes së marrëveshjes,” tha një pjesëmarrës. “Kur shoh se çfarë kanë pranuar Finlanda dhe Suedia në negociatat me Turqinë për anëtarësimin e tyre në NATO, dyshoj se Kosova dhe Serbia do të ishin gati për të bërë kompromise të ngjashme.” Në rastin e dy vendeve skandinave, perspektivat e së ardhmes mbizotëruan.

Një pjesëmarrës theksoi se Prishtina refuzon të kuptojë se ka pasur një ndryshim paradigme dhe se ka urgjencë për të zbatuar marrëveshjet, e jo për të diskutuar cilësinë e asaj që tashmë është nënshkruar. “Ne duhet të lëmë pas të kaluarën dhe të përqendrohemi në të ardhmen.” “Pa të, humbja për Kosovën do të jetë e madhe – procesi i integritimit në BE do të ngecë dhe nuk do të ketë liberalizim të vizave.” “Kosova duhet të kërkojë një marrëveshje dhe së bashku me Beogradin të ecin tutje përtej flluskave etnike dhe kombëtare.”

Deputetët u fokusuan kryesisht në procesin në vazhdim dhe paraqitën mendimet e tyre për atë që pala tjetër po bën gabim. Deputetët serbë kritikuan ashpër “mungesën e vullnetit të Prishtinës” për të zbatuar elementet e mbetura të Marrëveshjes së Brukselit të vitit 2013 dhe, në veçanti, ASM-në, por edhe mungesën e vullnetit politik për të zbatuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për manastirin e Deçanit. Përveç kësaj, disa prej tyre thanë se qasja aktuale e qeverisë së Kosovës po minon besimin e ndërtuar në mes të komunitetit serb dhe shqiptar ndër vite. Deputetët nga Kosova theksuan se “Kosova ka ndryshuar, por Serbia jo.” “Serbia ka ngecur në të kaluarën, nuk është demokratike, por Kosova nuk ka zgjidhje tjetër veçse të negociojë me qeverinë aktuale serbe,” tha njëri nga pjesëmarrësit. Një tjetër deputet tha se Serbia është e interesuar të zgjasë procesin ndërsa Kosova është e interesuar ta mbyllë atë.

Një deputet nga Kosova këmbënguli që BE-ja duhet të fokusohet më shumë në shkeljen e praktikave të mira demokratike dhe mungesën e sundimit të ligjit. Një deputet i opozitës nga Serbia përsëriti se ekziston një problem me BE-në dhe pjesën tjetër të komunitetit ndërkombëtar të cilëve u mungojnë “karrotat dhe shkopinjtë.”

Disa nga deputetët nga Serbia theksuan se nuk është vetëm Beogradi që nuk është i interesuar për një marrëveshje përfundimtare, por se edhe Kosova po silllet në mënyrë të ngjashme. Të dyja palët tregojnë se nuk kanë interes konkret për dialogun dhe dëshmia më e mirë është retorika që përdorin dhe kushtet që vendosin. “Nëse doni të flisni me palën tjetër, atëherë emrat si ‘Putini i vogël’ ose ‘Hitleri i vogël’ duhet të shmangen.” Një pjesëmarrës nga Prishtina tha se dialogu duhet të ketë një fuqi transformuese në shoqëritë tona, “edhe nëse nuk kemi një marrëveshje përfundimtare, të paktën të kemi një marrëveshje që na afron.”

“Dialogu nuk është transparent sa duhet dhe këto diskutime duhet të jenë më të hapura për publikun.” Pa më shumë transparencë, serbët dhe shqiptarët do të mbeten në flluskat e tyre. “Serbët nuk dinë për problemet me të cilat ballafaqohen shqiptarët e Kosovës. E njëjta gjë vlen edhe për shqiptarët e Kosovës për problemet serbe. Ata besojnë se është e lehtë për Serbinë të njohë Kosovën – nuk do të jetë e lehtë.” Një problem tjetër është se “të gjithë e dinë se çfarë dëshiron Prishtina, por nuk është e qartë se çfarë dëshiron Beogradi.”

Disa nga deputetët e Serbisë ftuan Kosovën t’i bashkohet iniciativës “Ballkani i Hapur.” “Iniciativa ka kontribuar në perceptime më të mira mes serbëve dhe maqedonasve dhe serbëve dhe shqiptarëve. Nuk ka asnjë arsye për të dyshuar se do të kontribuonte pozitivisht në marrëdhëniet Beograd-Prishtinë.”

## **Intensifikimi i bashkëpunimit ekonomik**

Në çështjet praktike, të pranishmit diskutuan tregtinë dhe bashkëpunimin ndërmjet odave ekonomike. Oda Ekonomike e Serbisë ka mbështetur anëtarësimin e Odës së Kosovës në “EuroChambers”. Tani, edhe Oda e Kosovës është anëtare e barabartë me odat e tjera nga Ballkani Perëndimor në Forumin e Investimeve të Odave.

Përfaqësuesit e të dy odave vlerësuan marrëdhëniet ndërmjet subjekteve afariste. Edhe pse ka një ndryshim të madh në madhësi dhe fuqi të ekonomive, nuk është vetëm Serbia që përfiton nga eksporti në Kosovë (rreth 400 milionë euro në vit). “Në tre muajt e fundit Kosova ka eksportuar

rreth 12 milionë euro, që paraqet një rritje prej 98% krahasuar me vitin para pandemisë.” Dhe shkëmbimi i përgjithshëm tregtar është rritur me më shumë se 10%. Eksportet serbe përbëjnë 30% të mallrave finale, ndërsa 70% janë produkte gjysëm të gatshme.

Megjithatë, problemet vazhdojnë. Meqenëse Serbia nuk e njeh Kosovën si një entitet të veçantë, mallrat nga/në BE nuk lejohen të kalojnë transit përmes Serbisë nëse vetëm Kosova përmendet si destinacion përfundimtar. Gjithashtu, ka edhe pengesa të tjera jotarifore, siç është mosnjohja e certifikatave specifike (veterinare). Edhe Kosova ka disa barriera jotarifore, por ato janë të papërfillshme në krahasim me jotariforet që Serbia i vendos Kosovës. “Me pak fjalë, politika kufizon perspektivën e plotë të bashkëpunimit ekonomik.” Disa pjesëmarrës insistuan se Brukseli nuk mund t'i zgjidhë këto çështje dhe se ato duhet të trajtohen në mënyrë bilaterale.

Gjithashtu, sfidat e transportit si mungesa e një hekurudhe funksionale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, apo problemet në bashkëpunimin ndërmjet shërbimeve postare, po e kufizojnë bashkëpunimin ekonomik. Këto probleme, megjithatë, i kufizojnë marrëdhëniet e përgjithshme ekonomike në tregti. Nëse pengesa të tilla do të tejkaloheshin dhe nëse do të kishte “sinjale” më të sakta politike nga drejtuesit, do të kishte një zgjerim të bashkëpunimit ekonomik dhe shfrytëzim më të mirë të të gjitha perspektivave që sjell CEFTA, si akumulimi diagonal i origjinës (RoO) dhe një qasje e përbashkët ndaj tregjeve të treta. Çështjet e tjera politike po krijojnë probleme për bizneset. Që kur Kosova iu bashkua ENTSO-E, Serbia bllokoi tranzitin e energjisë përmes Serbisë. Tani, Kosova mund të importojë energji vetëm përmes Maqedonisë së Veriut ose Malit të Zi, e cila është më e shtrenjtë dhe kështu minon prodhuesit dhe sipërmarrësit.

Forumet rajonale duhet të jenë ndër vendet ku mund të diskutohen këto aspekte. “Iniciativat rajonale sjellin përfitime për të gjitha palët, rrisin tregtinë në rajon dhe me Evropën.” “Investitorët kanë nevojë për stabilitet politik” dhe janë në favor të “qasjes rajonale.” Me kthimin gradual të investitorëve evropianë nga Kina, Ballkani bëhet gjithnjë e më interesant për ta për aktivitetin e ashtuquajtur “nearshoring”. Por ata favorizojnë një qasje rajonale, pasi tregjet kombëtare veçmas janë të vogla.

## PJESËMARRËSIT

*Sipas rendit alfabetik anglisht*

**Teuta Arifi**, Nënkryetare e Bashkimit Demokratik për Integrim; ish-Zëvendës Kryeministre e Maqedonisë së Veriut; ish-Kryetare e komunës së Tetovës

**Gresa Baftiu**, Bashkëpunëtore në Kosovë, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse

**Saranda Bogujevci**, Deputete e Parlamentit të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje

**Nenad Djurdjevic**, Këshilltar i Presidentit të Odës Ekonomike të Serbisë

**Dubravka Filipovski**, Deputete e Parlamentit të Serbisë, Partia Progresive Serbe

**Shpetim Gashi**, Zëvendës President, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse

**Dukagjin Gorani**, Ish-Deputet i Parlamentit të Kosovës, Partia Social Demokrate

**Vincent Hug**, Këshilltar për Sigurinë Njerëzore, Departamenti Zvicerian për Punë të Jashtme

**Dalibor Jevtic**, Zëvendës President, Lista Serbe; Kryetar i Shtërpcës

**Dusan Jovanovic**, Anëtar, Sekretariati Ndërkombëtar, Iniciativa “Mos Lejoni të Përmbysset Beogradi”

**Thomas Kolly**, Ambasador i Zvicrës në Kosovë

**Petar Miletic**, Ish-Deputet i Parlamentit të Kosovës, Partia Liberale e Pavarur

**Besian Mustafa**, Deputet i Parlamentit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës

**Igor Novakovic**, Bashkëpunëtor në Serbi, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse

**Anna Oreg**, Deputete e Parlamentit të Serbisë, Lëvizja e Qytetarëve të Lirë

**Zoran Ostojic**, Ish-Deputet i Parlamentit të Serbisë, Partia Liberale Demokratike

**Fitore Pacolli Dalipi**, Deputete e Parlamentit të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje

**Zenun Pajaziti**, Ish-Deputet i Parlamentit të Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës

**Snezana Paunovic**, Deputete e Parlamentit të Serbisë, Partia Socialiste e Serbisë

**Alex Roinishvili Grigorev**, President, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse

**Berat Rukiqi**, President, Oda Ekonomike e Kosovës

**Urs Schmid**, Ambasador i Zvicrës në Serbi dhe Mal të Zi

**Radmila Shekerinska**, Ish Zëvendës Kryeministre dhe Ministre e Mbrojtjes e Maqedonisë së Veriut; ish-Kryetare e Bashkimit Social Demokratik të Maqedonisë

**Dragan Sormaz**, Ish-Deputet i Parlamentit të Serbisë, Partia Progresive Serbe

**Jeta Statovci**, Deputete e Parlamentit të Kosovës, Lista Guxo

**Janko Veselinovic**, Deputet i Parlamentit të Serbisë, Lëvizja për Ndryshim

**Visar Ymeri**, Ish-Deputet i Parlamentit të Kosovës, Partia Social Demokrate